
POSTIM ARKIVOR

Shpërthimi i bombës në Ambasadën Sovjetike dhe ekzekutimi pa gjyq i Sabiha Kasimati dhe 21 intelektualëve të tjerë

Sabiha Kasimati


MINISTRIJA P. MBRENDESHME
Drejtorija e Sigurimit Shtetit
Dega Seksioni – P. Mbrendëshme
TEPER SEKRET
Model 7
Nr. i Regj.
1687
DOSJA E HETUESIS
Për:
Akuza:
Në bazë të nenit:
Të lig jit:
Data e fillimit 195
Data e mbarimit:
ARSHIVUAR:
Nr. Data
Arsyeja e Arshivimit
251 "A"

SEKSIONI

Figura historike

PERIUDHA

1937 - 1991

Pas shpërthimit të një sasie të vogël dinamiti në oborrin e Ambasadës Sovjetike më 19 shkurt, regjimi komunist e përdori këtë ngjarje si pretekst për të sulmuar elitën intelektuale. Sabiha Kasimati së bashku me 21 intelektualë të tjerë u arrestuan dhe akuzuan pa prova konkrete si "armiq të popullit" dhe "terroristë". Pa mundësi për mbrojtje dhe pa një gjykim të rregullt, ata u pushkatuan pranë Urës së Beshirit më 26 shkurt 1951, ndërkohë që vendimi për ekzekutim u mor më 27 shkurt 1951, një ditë pas vdekjes së tyre. Pas rënies së regjimit komunist në vitin 1991, familjarët e viktimave kërkuan zbardhjen e ngjarjes dhe identifikimin e vendit të ekzekutimit. Plenumi i Gjykatës së Lartë i shpalli të pafajshëm të dënuarit, duke e cilësuar vendimin nr. 64, datë 27.02.1951 të Gjykatës së Lartë Ushtarake si të kundërligjshëm dhe të pambështetur në prova konkrete. Pas hetimeve, në vitin 1993 u identifikua vendi i ekzekutimit dhe eshtrat e viktimave u varrosën me nderime në varrezat e Dëshmorëve të Kombit.

PERMBAJTJE #1


Sabiha Kasimati në dosjet e Sigurimit të Shtetit

Investigation File No. 1687 in the State Security Archives consists of 246 pages, of which only 14 have been selected for inclusion in this post. The file documents one of the darkest episodes in the history of the communist dictatorship in Albania: the arrests and executions carried out between February 20 and 23, 1951. The events were directly linked to the bombing of the Soviet Embassy in Tirana, which was used by the communist regime as a pretext for launching an immediate wave of arrests, unlawful interrogations, and extrajudicial executions. The arrests were carried out without arrest warrants issued by a prosecutor and without court decisions, rendering them entirely unlawful. Only after the detainees had been executed were the arrest warrants and records of the so-called “trial” formally prepared, in an attempt to provide legal justification for a decision that had already been made. According to Decision No. 64, dated February 27, 1951, of the Military Supreme Court, the arrested group was accused of being enemies of the people’s power. The accusation was based on the claim that the group consisted of members of the upper social classes, former officials, and individuals who had lost their privileges and who allegedly sought to overthrow the regime by force. The charges included anti-government propaganda and hostile activities, which were used as the basis for imposing the death penalty and carrying out the executions. The file also contains a petition submitted by the victims’ family members to the highest state institutions on June 24, 1991, requesting a full investigation into the circumstances surrounding the executions, the determination of the exact number of victims, and the identification of the location of their graves or the mass grave where their bodies had been buried. The petition emphasizes that, even after more than 40 years, the truth remained concealed. Following consideration of the petition, by Decision No. 64, dated August 10, 1991, the Plenum of the Supreme Court ordered the annulment of the 1951 decision, considering it a serious violation of the law and of fundamental human rights.

MEDIA #1

Letra e familjarëve të viktimave të pushkatuar pa gjyq

MEDIA FAQE #1



KUVENDIT POPULLOR
PRESIDENTIT RAMIZ ALIA
MINISTRISE SE DREJTESISE
GJYKATES SE LARTE
PROKURORISE SE PERGJITHSHME
MINISTRISE SE PUNEVE TE BRENDSHME
FORUMIT PER MBROJTJEN E TE DREJTAVE TE NJERIUT

Tirane 24-VI-1991

Ne, gjysetaret e familjeve qe kemi te pushkatuar njerezit tane pa gjyq ne periudhen shkurt-mars 1951 paraqesim kerkesen si me poshte:

Dihet se ne periudhen shkurt-mars 1951 ne Tirane, ne kushte et e terrorit, u arrestuan dhe ne mungese te procesit gjyqesor, u pushkatuan prinderit tane. Eshte raprezalja me e eger e popullsise civile te pafajshme, e organizuar nga furcat e erreta kriminale ne pushtet, veprim kerjtesisht i pajustifekueshem, mbasi isnte viti 1951 pra pas shtate vitesh clirimi dhe konsolidimi te pushtetit Popullor.

Eshte per tu theksuar qendrimi burreror i zoterinjve Manol Konomi dhe Teodor Heba te cilet protestuan ndaj masakres qe u be ne mungesa te nje procesi gjyqesor, dhe dhane dorehoqjen nga detyrat e tyre.

Jane te njohura persekutimet politike te pjesetareve te fa miljeve, si: burgosje, internime,diskriminime dhe shpronesime qe si pas ligjit enverist vazhduan deri ne breznite e treta bile dhe te ka terta. Kane kaluar dyzete vjet dhe ne ende sot, nuk e dime dhe nuk e njohim aresyen dhe arsyetimin e pushkatimit, numrin e sakte te viktim ave (dikush thote 72, ndeshta ?) dhe vendin (gropen o perbashket)k ku jane hedhur kufomat.

Realiteti i ri qe po jetojme qendrimi kritik dhe i prere i te gjitha forcave politike ndaj luftes se klasave dhe gabimeve te se kaluares deshira e sinqerte e te gjitheve per pajtim kombetar, pace sociale e progres demokratik na jep te drejten dhe ne qe te bejme kerkese per kete ceshtje:


1. Ne driten e te vertetes te benet rehabilitimi politik zyrtar i v iktimave te pushkatuara.

2. Te jepet urdher qe ne rruge legale ligjore, te shvillohen hetimet per te zbuluar gropen e perbashket ku treten eshtrat e prinderve tane te pafajshmruar.

Zgjidhjen e dy kerkesave te mesiperme e konsiderojme detyre norale dhe ceshtje nderi per gjithe kombin shqipetar.

Letra e familjarëve të viktimave të pushkatuar pa gjyq

MEDIA FAQE #2



Le te sherbeja kjo zgjidhje mbare kombit brenda dhe jashte
Atdheut se demokratizimi ne Shqiperi eshte nje realiteti kohes dhe
i pakthyeshem dhe se forcat e erreta te neteve te zeza te shkurtit
te pergjakur nuk do ti bien ne qafe kurre me popullit te shumevu-
ajtur shqipetar.

Me nderime

Familiaret e viktimave

Letra e familjarëve të viktimave të pushkatuar pa gjyq

INFORMACION

Letra e familjarëve të viktimave të pushkatuar pa gjyq

	1991
DOSJA	1687
TIPOLOGJIA E DOSJES	Hetuesie
	1937-1991
NIVELI I KLASIFIKIMIT	Tepër sekret


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #2

Lista emërore e personave të pushkatuar

MEDIA FAQE #1



GJYKATES SE LARTE

Ketu poshte po ju dergojme nje pjese te listes emerore me gjeneralitetet perkatese te personave te pushkatuar pa gjyq me shkurt te vitit 1951 :

1.	Thoma	Theodhos Katerina	Katundi	1986
2.	Jonuz	Osman Zyra	Kaceli	1910
3.	Gjon	Mark Marie	Temali	1904
4.	Anton	Shtefon Liza	Delhysa	1904
5.	Rais	Xhevdet Zakije	Selfo	1898
6.	Sabiha	Abdurrahman Zehra	Kasimati	1912
7.	Gafur	Tefik Shqere	Jegeni	1903
8.	Myftar	Sakip Fetije	Jegeni	1912
9.	Resait	Muharrem Baftisha	Shima	1919
10.	Zyhdi	Xhemal Lule	Kerri	1921
11.	Fadil	Shyqyri Hafsa	Dizdari	1919
12	Tefik	Hysen Nasibe	Shehu	1912
13.	Manush	Tahsin Merko	Peshkepia	1910
14.	Pjeter	Filip Liza	Gurazizi	1906
15.	Niko		Lezo	
16.	Qemal		Kasaruho	
17.	Ali	Masar Qamile	Qaraliu	1886
18.	Hekuran		Treska	
19.	Haki		K dra	
20	Rexhep	Osman Lule	picari	1914
21.	Zenel	Ali Sabrie	Rika	1928

8.07.1991

8-VI-1991

ADHAND PESHKEPIA

Nr. 57 Prot. AQSH Date 29.01.2026

Lista emërore e personave të pushkatuar

INFORMACION

Lista emërore e personave të pushkatuar


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #3

Kryetari i Gjykatës së Lartë Kleanth Koçi, i drejtohet Pleniumit të Gjykatës së Lartë për prishjen e Vendimit

MEDIA FAQE #1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
Nr._____

Tiranë, më _____1991

K Ë R K E S Ë
PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË
K U N D Ë R
Vendimit Nr.64, datë 27.2.1951, të gjykatës së Lartë Ushtarake.
P Ë R P.AR A
PLENUMIT TË GJYKATËS SË LARTË
T I R A N Ë

Me vendimin Nr.64, datë 27.2.1951, të gjykatës së Lartë Ushtarake, është vendosur deklarimi fajtor i të gjykuarve : Tefik Shehu, Hekuran Troka, Lluka Rashkoviç, Haki Kodra, Fandeli Nova, Thoma Katundi, Fadil Dizdari, Ali Qorallia, Jonuz Kaceli, Gafur Jegeni, Petro Ekonomi, Zyhdi Herri, Niko Leco, Myftar Jegeni, Qemal Kacaruho, Manush Peshkëpia, Andon Delhysa, Reis Selfo, Gjon Temali, Fjetrin Curaziu, Mehmet Shkupi dhe Sabiha Kasimati, për faje kundër popullit e shtetit, e në bazë të neneve 2 dhe 3 (pikat 7,8 e 10) të Ligjit Nr.372, datë 12.12.1946, janë dënuar me vdekje.

Ky vendim është i kundërligjshëm dhe nuk mbështetet në asnjë provë.

Me aktakuzën datë 25.2.1951, të prokurorit ushtarak, të gjithë të gjykuarit janë dërguar për gjykim në Gjykatën e Lartë Ushtarake ndën akuzën për faje kundër popullit e shtetit, të parashikuar nga Ligji Nr.372, datë 12.12.1946. Siç rezulton nga aktet e dosjes hetimore, asnjërit prej të gjykuarve nuk u është komunikuar ndonjë akuzë, ndërsa vetëm njëri prej tyre, i gjykuari Gjon Temali, është pyetur nga Seksioni i Sigurimit të Shtetit (edhe në këtë rast nuk i është komunikuar ndonjë akuzë konkrete), por vetëm thuhet "mbi akutën që i atribuohet". Ky procesverbal, që mban po datën 25.2.1951, nuk është nënshkruar as nga i akuzuari dhe as nga personat që e kanë marrë atë në pyetje. Asnjë provë tjetër nuk ka shoqërar dosjen hetimore.


Gjykata ka filluar shqyrtimin e çështjes më 26.2.1951. Kjo seancë gjyqësore është zhvilluar pa pjesëmarrje të prokurorit dhe të avokatëve mbrojtës. Sikundër rezulton nga ky procesverbal, në seancë gjyqësore, janë dëgjuar vetëm të gjykuarit të cilët janë pyetur fare shkurt. Procesverbali jo vetëm që nuk është firmosur nga kryetari e sekretari i seancës, por as që është mbyllur. Pra nuk mund të thuhet as dhe përse vendimi mban datën 27.2.1951.

Në pjesën hyrëse të vendimit thuhet se çështja është shqyrtuar në

./..

Kryetari i Gjykatës së Lartë Kleanth Koçi, i drejtohet Pleniumit të Gjykatës së Lartë për prishjen e Vendimit

MEDIA FAQE #2



- 2 -

bazë të ligjit të ri për aktet terroriste, pa përmendur cili është ai akt dhe as kohën e daljes së tij. Në këtë rast duhet të jetë fjala për dekretin Nr.1223, datë 26.2.1951, që është miratuar po ditën e shqyrtimit të çështjes në gjykatë. Duke qenë çështja kështu, edhe në bazë të atij dekreti, shqyrtimi i çështjes në gjykatë, ka qenë i kundërligjshëm. Kjo për arsye se të gjitha veprimet hetimore janë kryer jo në bazë të ligjit, mbasi ato janë kryer pa dalë ligji i ri. Pra veprimet hetimore e gjyqësore i kanë paraprirë ligjit.

Dhe të gjitha këto veprime të kundërligjshme, mbyllen me një vendim po të kundërligjshëm. Në vendim gjyqësor megjithëse akuzohen për organizim e pjesëmarrje në organizatë terroriste, nuk sillet asnjë provë dhe nuk bëhet asnjë analizë. Përkundrazi, edhe nga shpjegimet e të gjykuarve nuk del asnjë e dhënë që ata jo më të jenë organizuar apo biseduar midis tyre për organizatën terroriste, por as dhe të kenë njohje.

Dhe së fundi vendimi gjyqësor, nuk nënshkruhet rregullisht nga gjithë trupi gjykues, mbasi mungon firma e një anëtari.

Të mara në tërësi këto shkelje të ligjit si dhe mungesa e plotë e një hetimi objektiv, e bëjnë vendimin e gjykatës të kundërligjshëm.

P R A N D A J ,

Në bazë të nenëve 179 e vijues të K P Penale,

K Ë R K O J :

Prishjen e vendimit penal Nr.64, datë 27.2.1951, të Gjykatës së Lartë Ushtarake dhe pushimi i çështjes.

K R Y E T A R I
/ Kleanth Koçi /

Kryetari i Gjykatës së Lartë Kleanth Koçi, i drejtohet Pleniumit të Gjykatës së Lartë për prishjen e Vendimit

INFORMACION

Kryetari i Gjykatës së Lartë Kleanth Koçi, i drejtohet Pleniumit të Gjykatës së Lartë për prishjen e Vendimit


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #4

Prishja e Vendimit nr. 64 datë 10.08.1991

MEDIA FAQE #1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
"P L E N U M I"

Nr.75 i Regj.Themeltar.
Nr.64 i Vendimit K.L.

V E N D I M
"NË EMËR TË POPULLIT"

Plenumi i Gjykatës së Lartë, i formuar nën kryesinë e :

Kleanth Koçi	, Kryetar	i Gjykatës së Lartë	
Fehmi Abdiu	, Zv/kryetar	i "	"
Lili Robo	, Anëtar	i "	"
Fatmira Laskaj	, Anëtare	e "	"
Tamara Malaj	, Anëtare	e "	"
Zija Vuci	, Anëtar	i "	"
Spiro Spiro	, Anëtar	i "	"
Viktor Ikonomi	, Anëtar	i "	"
Avni Shehu	, Anëtar	i "	"
Qazim Gjonaj	, Anëtar	i "	"
Muharrem Kushi	, Anëtar	i "	"
Agim Shkupi	, Anëtar	i "	"

me sekretare Fato Korvafaj dhe me pjesëmarrjen e zëvëndësprokurorit të Përgjithshëm Spiro Peçi, në seancë gjyqësore me datë 10.8.1991, mori në shqyrtim çështjen penale Nr.75 KL që u përket të gjykuarve :


1. TEFIK SHEHU , i biri i Hysenit dhe i Nasibesë, i dtl. 1912, lindur në Gjakovë e banues në Tiranë, me profesion tregtar, shtresë e pasur, i arrestuar më 20.2.1951.

2. HEKURAN TROKA , i biri i Idrizit dhe i Qamiles, i

./..

Prishja e Vendimit nr. 64 datë 10.08.1991

MEDIA FAQE #2



- 2 -

dtl.1918, lindur në Kuçovë e banues në Tiranë, tregtar, autodidakt, i arrestuar më 20.2.1951.

3. LLUKA RASHKOVIQ , i biri i Kristos dhe i Angjelinës, i dtl.1892, lindur në Malteci, banues në Tiranë, me arsim fillor, mekanik, i arrestuar më 20.2.1951.

4. HAKI KODRA , i biri i Rexhepit dhe i Hazbijes, i dtl.1918, lindur në Dibër të Madhe e banues në Tiranë, nëpunës, i arrestuar më 20.2.1951.

5. PANDELI NOVA , i biri i Kostas dhe i Vasiles, i i dtl.1892, lindur në Korçë e banues në Tiranë, me arsim fillor, tregtar, shtresë e pasur, i arrestuar më 22.2.1951.

6. THOMA KATUNDI , i biri i Theodhorit dhe i Katerinës, i dtl.1886, lindur në Korçë e banues në Tiranë, marangoz, i arrestuar më 20.2.1951.

7. FADIL DIZDARI , i biri i Shyqyriut dhe i Hafsasë, i dtl.1916, lindur në Kavajë e banues në Tiranë, tregtar, i arrestuar më 20.2.1951.

8. ALI QORALLIA , i biri i Masarit dhe i Qamiles, i dtl.1890, lindur e banues në Tiranë, shtresë e pasur, i arrestuar më 20.2.1951.

9. JONUZ KAÇELI , i biri i Osmanit dhe i Zyhrasë, i dtl.1908, lindur e banues në Tiranë, tregtar, shtresë e pasur, i arrestuar më 20.2.1951.

10. GAFUR JEGENI , i biri i Tefikut dhe i Sheqeries, i dtl.1907, lindur në Dibër të Madhe e banues në Tiranë, ish-oficer i Zogut, bujk, shtresë e mesme, i arrestuar më 20.2.1951.

11. PETRO EKONOMI , i biri i Stefanit dhe i Sanes, i dtl.1921, lindur në Kajro (Egjipt) e banues në Tiranë, nëpunës, shtresë e pasur, i arrestuar më 21.2.1951.


12. ZYHDI HERRI , i biri i Xhemelit dhe i Lulës, i dtl.1920, lindur e banues në Tiranë, nëpunës, shtresë e pasur, i arrestuar më 20.2.1951.

13. NIKO LEZO , i biri i Vangjelit dhe i Hajdhos, i dtl.1891, lindur në Delvinë e banues në Tiranë, inxhinier kimist, shtresë e pasur, i arrestuar më 23.2.1951.

./..

Prishja e Vendimit nr. 64 datë 10.08.1991

MEDIA FAQE #3



- 3 -

14. MYFTAR JEGENI , lindur në Dibër të Madhe, banues në Tiranë, nëpunës, i arrestuar më 20.2.1951.

15. QEMAL KAÇARUHO , i biri i Nuriut, i dtl.1902, lindur në Gjirokastër e banues në Tiranë, shtresë e pasur, nëpunës, i arrestuar më 20.2.1951.

16. MANUSH PESHKËPIA , i biri i Tasimit dhe i Marsijes, lindur në Vlorë e banues në Tiranë, shtresë e pasur, i dënuar më 1945 si kriminel lufte, nëpunës, i arrestuar më 20.2.1951.

17. ANDON DELHYSA , i biri i Stefanit dhe i Lizës, i dtl. 1904, lindur në Prizren (Kosovë) e banues në Tiranë, teknik ndërtimi, shtresë e pasur, i arrestuar më 20.2.1951.

18. REIS SELFO , i biri i Xhevdetit dhe i Zakijes, i dtl. 1896, lindur në Gjirokastër e banues në Tiranë, tregtar, shtresë e pasur, i arrestuar më 23.2.1951.

19. GJON TEMALI , i biri i Markut dhe i Marijes, i dtl. 1904, lindur në Shkodër e banues në Tiranë, farmacist, i arrestuar më 20.2.1951.

20. PJERIN GURAZIU , i biri i Filipit dhe i Lizës, i dtl. 1903, lindur në Shkodër e banues në Tiranë, nëpunës, shtresë e pasur, i arrestuar më 22.2.1951.

21. MEHMET SHKUPI , i biri i Aliut dhe i Elifes, i dtl. 1893, lindur në Shkup e banues në Tiranë, kaloriferist, i arrestuar më 20.2.1951.

22. SABIHAN KASIMATI , e bija e Abdurramanit dhe e Zerasë, e dtl.1916, lindur në Turqi e banuese në Tiranë, nëpunëse, e arrestuar më 20.2.1951.

T Ë A K U Z U A R :


Për faje kundër popullit dhe shtetit, parashikuar nga nenet 2 dhe 3 (pikat 7,8 dhe 10) të Ligjit Nr.372, datë 12.12.1946.

Me vendimin Nr.64, datë 27.2.1951, të Gjykatës së Lartë Ushtarake Tiranë, është vendosur deklarimi fajtorë i të gjithë të gjykuarve për krimin e kryer kundër popullit dhe shtetit dhe në bazë të neneve 2 dhe 3 (7,8 dhe 10) të Ligjit Nr.372, datë 12.12.1946, të gjithë janë dënuar me vdekje.

./..

Prishja e Vendimit nr. 64 datë 10.08.1991

MEDIA FAQE #4



- 4 -

Kundër vendimit të mësipërm ka bërë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kryetari i Gjykatës së Lartë, duke kërkuar prishjen e tij dhe pushimin e çështjes duke i deklaruar ata të pafajshëm për këto shkaqe :

- Vendimi i gjykatës nuk mbështetet në asnjë provë dhe është i kundërligjshëm.

- Nga materialet e kësaj dosjeje, rezulton se nuk janë zbatuar rregullat procedurale kryesore, si vendimi për fillim të çështjes penale, nuk u është komunikuar ndonjë akuzë, nuk janë pyetur dhe nuk kanë dhënë asnjë shpjegim në hetuesi (me përjashtim të të gjykuarit Gjon Temali), nuk u është komunikuar kopja e akt-akuzës etj.

- Edhe në seancë gjyqësore, të gjykuarit janë pyetur fare shkurt, nuk janë ballafaquar dhe nuk është administruar asnjë provë tjetër.

- Çështja është shqyrtuar në gjykatë më 26.2.1951, pra ditën që ka dalë Dekreti i Ri Nr.1223, datë 26.2.1951, "Mbi hetimin e gjykimin e veprave terroriste". Duke qenë kështu, edhe në bazë të atij dekreti, shqyrtimi i çështjes në gjykatë ka qenë i kundërligjshëm për arsye se të gjitha veprimet hetimore janë kryer pa dalë ligji i ri.

- Vendimi përfundimtar i gjykatës nuk është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues, mbasi mungon firma e njërit prej anëtarëve.

PLENUMI I GJYKATËS SË LARTË ,

pasi dëgjoi relacionin e anëtarit Agim Shkupi, zëvendësprokurorin e Përgjithshëm, Spiro Peçi, që shfaqi mendimin për prenimin e kërkesës si dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,


V Ë R E N :

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e drejtë dhe duhet pranuar në tërësi.

./..

Prishja e Vendimit nr. 64 datë 10.08.1991

MEDIA FAQE #5



- 5 -

Me akt-akuzën datë 25.2.1951, të prokurorit ushtarak të gjykuarit : Tefik Shehu, Hekuren Troka, Lluka Rashkoviç, Haki Kodra, Pandeli Nova, Thoma Katundi, Fadil Dizdari, Ali Qorallia, Jonuz Kaceli, Gafur Jegeni, Petro Ekonomi, Zyhdi Herri, Niko Lezo, Myftar Jegeni, Qemal Kacaruho, Manush Peshkëpia, Andon Delhysa, Reis Selfo, Gjon Temali, Fjetrin Guraziu, Mehmet Shkupi dhe Sabiha Kasimati, janë dërguar për gjykim në Gjykatën e Lartë Ushtarake Tiranë ndën akuzën për feje kundër popullit e shtetit, të parashikuar nga nenet 2 dhe 3 (pikat 7, 8 dhe 10) të Ligjit Nr.372, datë 12.12.1946.


Megjithëse bëhet fjalë për akuza shumë të rënda, dosja hetimore nuk përmban asnjë provë. Jo vetëm që nuk janë pyetur të gjykuarit (me përjashtim të Gjon Temalit), por nuk është pyetur asnjë dëshmitar apo nuk është administruar ndonjë provë shkresore që të faqësonte të gjykuarit. Po ashtu, nuk ka vendim mbi fillimin e çështjes penale, vendim mbi marrjen si të pandehur dhe komunikim të akuzës dhe përfundimisht as akt-akuza nuk u është dorëzuar apo bërë e njohur të pandehurve. Të gjitha këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit.

Gjykata, çështjen e ka shqyrtuar në seancë gjyqësore më 26.2.1951, pa pjesëmarrje të prokurorit dhe të avokatëve mbrojtës. Sikundër rezulton nga procesverbali, në seancë gjyqësore janë dëgjuar vetëm të pandehurit të cilët janë pyetur fare shkurt. Megjithëse ata janë akuzuar për organizim e pjesëmarrje në një organizatë terroriste, gjykata nuk është ndalur fare për vërtetimin e kësaj akuze. Përkundrazi, nga shpjegimet që kanë dhënë të gjykuarit, ka dalë se ata jo vetëmqë nuk kanë krijuar apo organizuar ndonjë organizatë terroriste por për më tepër ata as që kanë qenë njohur apo të kenë patur ndonjë lidhje midis tyre. Në mungesë të hetimeve paraprake (hetuesisë), gjykatësi binte si detyrë që të paktën çështjen ta hetonte në mënyrë të plotë në seancë gjyqësore. Por dhe këtë detyrë gjykata nuk e ka realizuar. Kështu jo vetëm që nuk është administruar ndonjë provë tjetër, si pyetje dëshmitarësh, administrim provash të tjera të nevojshme, por as që janë bërë ballafaqime midis të gjykuarve. Pra mungesa e hetimit ka vazhduar dhe në gjykim. Dhe në fakt, edhe gjykata nuk ka patur se çfarë të hetonte, mbasi nuk ka patur asnjë fakt që të gjykuarit të kishin kryer ndonjë aktivitet armiqësor kundër popullit dhe shtetit.

./..

Prishja e Vendimit nr. 64 datë 10.08.1991

MEDIA FAQE #6



- 6 -

Nga ana tjetër, në vendimin e gjykatës thuhet se çështja është shqyrtuar në bazë të rregullave që parashikon Ligji i Ri "Mbi hetimin e gjykimin e veprave terroriste", pa përmendur se cili është ky ligj. Në këtë rast duhet të jetë fjala për Dekretin Nr.1223, datë 26.2.1951, pra që është nxjerrë pa ditën e shqyrtimit të çështjes në gjykatë.

Duke qenë kështu, edhe gjykata nuk e ka patur parasysh në shqyrtimin e çështjes, mbasi po atë ditë që ka dalë ai dekret është shfilluar dhe seanca gjyqësore.

Dhe së fundi procesverbali i seancës gjyqësore jo vetëm që nuk është nënshkruar nga kryetari i seancës dhe sekretari, por as është mbyllur. Po ashtu dhe në vendimin përfundimtar të gjykatës, mungon firma e një anëtari të trupit gjykues.

Të mara në tërësi këto shkelje të ligjit si dhe mungesa e plotë e fakteve dhe e provave, e bëjnë vendimin të kundërligjshëm. Për rrjedhojë, përderisa nuk vërtetohet që të gjykuarit të kenë kryer veprën penale për të cilën janë deklaruar fajtorë dhe dënuar, çështja penale në ngarkim të tyre duhet të pushohet dhe ata të deklarohen të pafajshëm.

PËR KËTO ARSYE ,

Plenumi i Gjykatës së Lartë, në bazë të neneve 182/2 dhe 185/3 të K P Penale,


V E N D O S I :

Prishjen e vendimit Nr.64, datë 27.2.1951, të Gjykatës së Lartë Ushtarake Tiranë dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të të gjykuarve : Tefik Shehu, Hekuren Troka, Lluka Rashkoviç, Haki Kodra, Pandeli Nova, Thoma Katundi, Fadil Dizdari, Ali Qorallia, Jonuz Kaceli, Gafur Jegeni, Petro Ekonomi, Zyhdi Herri, Niko Lezo, Myftar Jegeni, Qemal Kacaruho, Manush Peshkëpia, Andon Delhysa, Reis Selfo, Gjon Temali, Fjetrin Guraziu, Mehmet Shkupi dhe Sabiha Kasimati.

./..

Prishja e Vendimit nr. 64 datë 10.08.1991

MEDIA FAQE #7



- 7 -

Tiranë, më 10.8.1991

ANËTAR / L. Robo /	ZV/KRYETAR / F. Abdiu /	KRYETAR / K. Koçi /
ANËTAR / Z.Vuci /	ANËTARE / T. Mëlaj /	ANËTARE / F. Leskaj /
ANËTAR / A.Shehu /	ANËTAR / V.Ikonomi /	ANËTAR / S. Spiro /
ANËTAR / A.Shkupi /	ANËTAR / M.Kushi /	ANËTAR / Q.Gjonaj /

D. F.

AIDSSH Nr. 67 Prot. Data 9.01.2026

Prishja e Vendimit nr. 64 datë 10.08.1991

INFORMACION

Prishja e Vendimit nr. 64 datë 10.08.1991


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #5

Raport Informativ i Sektorit të Bandave datë 19.07.1951

MEDIA FAQE #1



VDEKJE FASHIZMIT LIRI POPULLIT

94

RAPORT INFORMATIV I SEKTORIT BANDAVE

DATË 19.VII.1951

Kukesi njofton: Se me daten 16.VII.951 prej ores 23'30 deri në orën 0'30 një ajroplan ka qerkulluar mbi kukës,Shemëri,Krumë Fan.Në megjezin e datës 17 janë gjetur fletushka të Komitetit Shqipërija e Lirë,të cilat flasën për hedhjen e bombës ne Legatën Sovjetike,për arrestimet qe jane bër etj.

Ne vende ku mund të zbarkojën njerëz ose material jane derguar forca.

Zv.KRYETARI I DEGES IX-te
Kapiten'i I-re
(Idriz Seiti)

Raport Informativ i Sektorit të Bandave datë 19.07.1951

INFORMACION

Raport Informativ i Sektorit të Bandave datë 19.07.1951

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #6

Përkujtime të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet të ish-Sigurimit të Shtetit në nderim të të ekzekutuarve në masakrën e 26 Shkurtit.

MEDIA FAQE #1



Përkujtime të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet të ish-Sigurimit të Shtetit në nderim të të ekzekutuarve në masakrën e 26 Shkurtit.

INFORMACION

Përkujtime të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet të ish-Sigurimit të Shtetit në nderim të të ekzekutuarve në masakrën e 26 Shkurtit.

Autoret: AIDSSH

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.